

VENDIM
Nr. 10, datë 11.2.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 15.1.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 5 (K) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kadri Pazari, Engjëll Kazazi, përfaqësuar nga avokatja Miranda Boçi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Etleva Prespa (Preza), Alba Zaloshnja (Preza), Rudina Petrela, Aisa Petrela, Danny Patrick Petrela, Eda Hysa, Hajrie Kika (Hysa), Ildika Fortuzi, Gledion Fortuzi, Edlira Dosti (Fortuzi), Adhurim Fortuzi, Liljana Fortuzi, Endrit Fortuzi, Fatjon Fortuzi, Abdi Hysa, Erida Bakiri, Valbona Fortuzi dhe Orvana Fortuzi, përfaqësuar nga avokatja Suela Mëneri, me prokurë.

Kujtim Pazari, Greta Beliu, Ami Narazani, Maria Narazani, Adrian Narazani, Qazim Çaçi, Arben Çaçi, Hiqmete Memia (Çaçi), Rezarta Dobra (Luzi), Ermira Luzi, Zana Shima, Ndriçim Kazazi, Donika Kazazi, Fatbardha Rama, Liri Pazari, Jona Pazari, Jeta Xhema dhe Etleva Xhema, përfaqësuar nga avokatja Miranda Boçi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1442, datë 5.6.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-2489, datë 12.6.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, Kadri Pazari dhe Engjëll Kazazi (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Etleva Prespa (Preza), Alba Zaloshnja (Preza), Rudina Petrela, Aisa Petrela, Danny Patrick Petrela, Eda Hysa, Hajrie Kika (Hysa), Ildika Fortuzi, Gledion Fortuzi, Edlira Dosti (Fortuzi), Adhurim Fortuzi, Liljana Fortuzi, Endrit Fortuzi, Fatjon Fortuzi, Abdi Hysa, Erida Bakiri, Valbona Fortuzi dhe Orvana Fortuzi (*palë paditëse në proces*), të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi se subjektet e tjera të interesuara, Kujtim Pazari, Greta Beliu, Ami Narazani, Maria Narazani, Adrian Narazani, Qazim Çaçi, Arben Çaçi, Hiqmete Memia (Çaçi), Rezarta Dobra (Luzi), Ermira Luzi, Zana Shima, Ndriçim Kazazi, Donika Kazazi, Fatbardha Rama, Liri Pazari, Jona Pazari, Jeta Xhema dhe Etleva Xhema (*palë e paditur në proces*), nuk paraqitën prapësime, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë të të ndjerit Sh.A.P., i cili, me anë të vendimit nr. 1104, datë 23.9.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*vendimi nr. 1104/1996 i KKKP-së*), është njohur pronar i një trualli me sipërfaqe 651.6 m² në Tiranë. Për këtë pasuri, subjektet e interesuara, palë paditëse në proces, të cilat janë në gjini të afërt me kërkuesit dhe trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit Sh.A.P., kanë kërkuar gjyqësisht njohjen si bashkëpronarë, me pretendimin se pasuria nuk ishte pronë e të ndjerit në origjinë, por e babait të tij. Për të vërtetuar të kundërtën, kërkuesit dhe trashëgimtarët e tjerë, palë e paditur në proces, kanë paraqitur si provë në procesin gjyqësor një kopje të noterizuar të vendimit nr. 518 (508), datë 2.2.1939, të Gjykatës së Paqit

Tiranë (*vendimi nr. 518 (508) i Gjykatës së Paqit*). Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. 1319, datë 12.3.1997, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1515, datë 11.6.1997, ndërsa Gjykata e Kasacionit, me vendimin nr. 1303, datë 7.11.1997, ka vendosur mospranimin e rekursit (*procesi kryesor*). Në vijim, subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, kanë paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit të formës së prerë, kërkesë e cila nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. 67 akti, datë 18.12.1997, nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 843, datë 6.5.1998 dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1478, datë 3.12.1998. Ndërsa, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 90, datë 25.7.2001, ka vendosur të rrëzojë kërkesën si të pabazuar.

2. Ndërkohë, lidhur me vendimin nr. 518 (508) të Gjykatës së Paqit, të administruar si provë në procesin kryesor, Prokuroria e Rrethit Tiranë ka filluar dy procedime penale për veprën e falsifikimit të dokumenteve, përkatësisht në vitet 1998 dhe 2004. Në rastin e parë, prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes penale, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8202, datë 27.3.1997, “Për amnistinë”. Pavarësisht kësaj, ajo ka arsyetuar se vendimi në fjalë është i falsifikuar në formë dhe në përmbajtje. Ndërsa, në rastin e dytë, prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se mungojnë elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 757 akti, datë 19.7.2004, nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 657, datë 6.10.2005 dhe nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 278, datë 13.3.2007.

3. Më 26.3.2003 subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, i janë drejtuar gjykatës, duke kërkuar deklarinimin të falsifikuar të vendimit nr. 518 (508) të Gjykatës së Paqit, bazuar në nenet 32 dhe 270 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë), me vendimin nr. 5353, datë 29.6.2010 (*vendimi nr. 5353/2010*), ka vendosur pranimin e padisë dhe deklarinimin të falsifikuar të vendimit, me arsyetimin se: i. ai nuk është gjendur në Arkivin e Shtetit; ii. emri dhe mbiemri i gjyqtarit paqtues dhe sekretarit janë shkruar me makinë shkrimi, ndryshe nga vendimet e tjera të gjetura në Arkivin e Shtetit; iii. në bazë të aktit të ekspertimit grafik, nënshkrimi në vendim nuk përputhet me modelin e krahasimit, si dhe ka papërputhshmëri të tjera. Për detyrën e lënë nga gjykata e apelit për ribërjen e aktit të ekspertimit, ajo gjykatë ka arsyetuar se ka qenë në pamundësi të realizimit të saj, për shkak se dosja hetimore e vitit 1998 nuk është gjendur nga organi procedues dhe, rrjedhimisht, nuk i është vënë në dispozicion.

4. Vendimi i mësipërm është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1862, datë 21.9.2011 (*vendimi nr. 1862/2011*), duke rrëzuar padinë e subjekteve të interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, me arsyetimin se vendimmarrja është mbështetur në një provë të marrë nga një procedim penal dhe jo sipas mënyrës së parashikuar nga KPC-ja, konkretisht neni 224/a i saj. Ndaj, sipas gjykatës së apelit, nuk vërtetohet pretendimi se vendimi nr. 518 (508) i Gjykatës së Paqit është i pavërtetë, i falsifikuar. Në këtë kuptim, ajo gjykatë ka çmuar se nuk ndodhej përpara një vendimi të formës së prerë, i cili do të ishte i detyrueshëm për gjykatën civile që shqyrton pasojat civile të veprës penale, për më tepër që çështja civile objekt gjykimi nuk është çështje ku shqyrtohen pasojat civile të veprës penale. Po kështu, sipas saj, thelbi i pretendimeve për pavërtetësinë e vendimit, pavarësisht mjetit procedural të përdorur, është shqyrtuar më parë nga gjykatat dhe është gjetur i pabazuar me vendime gjyqësore të formës së prerë, rrjedhimisht përbën “gjë të gjykuar”.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 38, datë 5.2.2016 (*vendimi nr. 38/2016*), ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me arsyetimin se nuk është kryer një hetim i plotë, i gjithanshëm dhe në përputhje me

ligjin. Për përfundimin e gjykatës së apelit se pretendimet për pavërtetësinë e vendimit në fjalë përbëjnë gjë të gjykuar, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ajo duhet të kishte arritur në këtë përfundim, pasi të kishte hetuar për ligjshmërinë e fitimit të pronësisë nga të paditurit në procesin kryesor (ndër ta kërkuarit/trashëgimlënësit e tyre) dhe, në kushtet kur është vënë në diskutim vërtetësia e provës thelbësore për fitimin e pronësisë nga ana e tyre, nuk mund të thuhet se jemi përpara gjësë së gjykuar”, pa i dhënë zgjidhje më parë këtij problemi, sipas saj. Ndaj, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se nuk mund të kemi cenim të parimit të sigurisë juridike për të drejta që pretendohet se janë fituar në mënyrë të kundërligjshme. Për gjykatën e apelit në rigjykim, Gjykata e Lartë ka lënë për detyrë: i. verifikimin nëse pasuria objekt mosmarrëveshjeje ka qenë pronë e trashëgimlënësit Sh.A.P. në origjinë ose nëse është fituar me trashëgim; ii. hetimin lidhur me përputhshmërinë ose jo të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Paqit me vendimin nr. 501 të vitit 1939 të të njëjtit gjyqtar të Gjykatës së Paqit.

6. Pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë me detyrat përkatëse, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1442, datë 5.6.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5353/2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në lidhje me detyrën e parë, për hetimin e origjinës së pronës, gjykata e apelit ka konkluduar se është provuar fakti se në asnjë rast nuk ka rezultuar të jetë lëshuar ndonjë dëshmi trashëgimie në emër të trashëgimlënësit të kërkuarve. Ndërsa lidhur me detyrën e dytë, gjykata e apelit ka konkluduar se vendimet nr. 508 dhe nr. 518 të vitit 1939 të Gjykatës së Paqit kanë përmbajtje të ndryshme nga vendimi i kundërshtuar dhe nga sa është pretenduar nga palët e paditura në proces. Në përfundim, ajo gjykatë ka çmuar se vendimi nr. 518 (508) i Gjykatës së Paqit është i falsifikuar dhe se kjo është provuar plotësisht nga akti i ekspertimit i administruar gjatë procedimit penal të vitit 1998, në të cilin, edhe pse çështja është pushuar për shkak të ligjit për amnistinë, është konkluduar që vendimi është i falsifikuar. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, ajo gjykatë ka çmuar se nuk qëndron, duke referuar në përgjigjen shteruese në vendimin nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë, si dhe në vlerësimin e saj se në asnjë nga vendimet gjyqësore të mëparshme nuk rezulton të jetë marrë në shqyrtim ky pretendim.

7. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur rekurs kërkuarit, palë e paditur në procesin kryesor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2489, datë 12.6.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Lidhur me pretendimin se çështja përbën “gjë të gjykuar”, ajo gjykatë ka arsyetuar se ky pretendim është marrë në shqyrtim gjatë gjykimeve të mëparshme dhe për të kërkuarit kanë marrë përgjigje.

8. Në datën 16.1.2025 kërkuarit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.1.2025, duke kundërshtuar në objektin e tij vendimin e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë (shih paragrafët 6 dhe 7 të vendimit). Kolegji i Gjykatës, në datën 1.4.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 25.9.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i çështjes. Ndërsa në datat 25.9.2025 dhe 17.10.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur për kalimin procedural të palëve në proces.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuarit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara u kanë cenuar:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

9.1.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur, dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit*, pasi kërkuesit nuk janë njoftuar për shqyrtimin e rekursit të tyre në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, edhe pse janë vënë në dispozicion adresat fizike të tyre dhe adresa elektronike e avokatit. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen me përparësi pas kërkesës së bërë nga subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, duke mos u dhënë mundësinë kërkuesve që të njihen me kërkesat e asaj pale. Në këto kushte, çështja nuk duhej shqyrtuar në dhomën e këshillimit, por duhej t'u jepej mundësia palëve të paraqisnin pretendimet e tyre në mënyrë të barabartë përpara gjykatës, duke përdorur të njëjtat armë dhe duke zhvilluar debatin gjyqësor dhe kontradiktoritetin, pa vendosur në disavantazh kërkuesit. Në gjykim nuk janë thirrur as trashëgimtarët e të paditurve që kanë ndërruar jetë, pasi Gjykata e Lartë nuk ka bërë zëvendësimin procedural të tyre.

9.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi me mospranimin e rekursit të kërkuesve Gjykata e Lartë nuk e ka cenuar vendimin e gjykatës së apelit, edhe pse kjo e fundit nuk i ka zbatuar detyrat e lëna me vendimin nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë. Konkretisht, gjykata e apelit, jo vetëm që nuk e ka realizuar detyrën kryesore për të hetuar origjinën e pronës, por nuk ka pranuar as të shqyrtojë dokumentet e kërkuesve që e vërtetonin atë. Gjykata e apelit nuk ka realizuar as detyrën tjetër të lënë nga Gjykata e Lartë lidhur me nxjerrjen nga Arkivi i Shtetit të vendimit të Gjykatës së Paqit, por është mjaftuar me deklarin se vendimi nuk gjendet në arkiv. Në kontradiktoritet me këtë pohim, ajo më pas ka deklaruar të falsifikuar një vendim që nuk gjendet.

9.1.3. *Parimit të sigurisë juridike* në aspektin e “*gjësë së gjykuar*”, pasi gjykatat në vendimet e kundërshtuara nuk kanë marrë në konsideratë parashikimin e nenit 451/a të KPC-së, sipas të cilit vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për gjitha gjykatat e institucionet e tjera dhe ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Në rastin konkret vendimet e mëparshme janë të formës së prerë, kanë të njëjtat palë, kanë të njëjtin objekt dhe bazë ligjore. Ato gjykata kanë bërë një interpretim tërësisht të ndryshëm nga vendimi nr. 1862/2011 i gjykatës së apelit, e cila e ka vlerësuar këtë çështje si gjë të gjykuar. Nga ana tjetër, gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, në procesin kryesor, është dorëzuar origjinali i vendimit të Gjykatës së Paqit, i cili është administruar si provë, ndaj falsiteti i vendimit të noterizuar nuk mund të pretendohet. Edhe akti i ekspertimit ka konfirmuar se dokumenti në tërësi ruan vjetërsinë tij, në këto kushte gjykata e apelit nuk ka kryer një riekspertim. Vite më vonë, gjykatat e kanë deklaruar të falsifikuar këtë dokument, duke u bazuar te një hetim i vitit 1998, pasi nuk është kryer dot një akt ekspertimi. Në çdo rast, vërtetësia ose jo e vendimit në fjalë nuk ka ndonjë rëndësi të posaçme për vërtetimin e pronësisë së kërkuesve, por është një provë si gjithë të tjerat.

9.2. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi për shkak të procesit të parregullt ligjor kërkuesve mund t'u cenohen pasuritë e trashëguara dhe të fituara me vendime të KKKP-ve, të cilat, në të shumtën e rasteve janë tjetërsuar tashmë.

10. ***Subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor***, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar si vijon:

10.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur, dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit* është i pabazuar, madje i pambështetur në ligj e në situatën faktike, pasi kërkuesit duhet të provojnë jo vetëm që nuk janë njoftuar për fazën e shqyrtimit të pranueshmërisë së rekursit, por se u kanë ardhur pasoja konkrete dhe të pakthyeshme në ushtrimin

efektiv të së drejtës për mbrojtje dhe në barazinë e palëve në proces nga mosnjohimi. Për më tepër, ky pretendim nuk mund të ngrihet në një fazë formale jokontradiktore të procesit (dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve), në kushtet kur vetë ligji nuk parashikon detyrimin për një njoftim të tillë. Pavarësisht se kanë paraqitur rekurs, kërkuessit kanë qëndruar pasivë gjatë gjithë periudhës 2018-2024, duke mos depozituar asnjë qëndrim, sqarim ose kërkesë për informacion dhe nuk rezulton të kenë pasur pengesë objektive që t'u ketë pamundësuar atyre ndjekjen e procedurës. Për sa i përket pretendimit se vdekja e ndonjërit prej tyre ka ndikuar në ndjekjen e procedurës, rekursi është paraqitur vetëm nga kërkuessit, të cilët janë gjallë.

10.2. Edhe pretendimi i kërkuessve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, me argumentin se gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, nuk qëndron, pasi rezulton se ajo i ka ndjekur të gjithë hapat proceduralë dhe ka realizuar hetime të plota në përputhje me standardet e vendosura nga Gjykata e Lartë. Këto pretendime, në thelb, përfaqësojnë një kundërshtim të vonuar ndaj vendimit nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë, i cili nuk është kontestuar në rrugë kushtetuese nga kërkuessit.

10.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në aspektin e “*gjësë së gjykuar*”, pasi Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 38/2016, ka konstatuar se vlefshmëria dhe ndikimi juridik i këtij vendimi përbëjnë çështje të hapur, e cila kërkon vlerësim të plotë dhe hetim material nga gjykatat e faktit, duke e përjashtuar kështu ekzistencën e “*gjësë së gjykuar*”. Vendimet e mosfillimit të procedimit penal nuk përbëjnë pengesë procedurale për vijimin e shqyrtimit civil. Për më tepër, kërkuessit kanë qëndrime kontradiktore lidhur me rëndësinë e kësaj prove, në kushtet që vetë ata e kanë trajtuar vendimin e Gjykatës së Paqit si provë qendrore për mbështetjen e pretendimeve të tyre pronësore.

10.4. Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi tjetër për cenimin e së drejtës së *pronës private*, pasi titulli i pronësisë, mbi të cilin mbështeten kërkuessit, nuk u është njohur atyre ligjërisht në mënyrë përfundimtare, çka përjashton ekzistencën e një të drejte të mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës.

11. ***Subjektet e interesuara, palë e paditur në procesin kryesor***, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata vlerëson se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës për të paraqitur ankim kushtetues individual, pasi kundërshtojnë procesin gjyqësor në të cilin kanë qenë palë, për rrjedhojë justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri legjitimimi, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar, mes të tjerash, se Gjykata e Lartë nuk ka bërë zëvendësimin procedural të disa të paditurve që kanë ndërruar jetë përpara se çështja të shqyrtohej në atë gjykatë, për pasojë trashëgimtarët e tyre nuk janë thirrur në gjykim. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se kërkuesit, si subjekt i kushtëzuar, në bazë të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, mund të bëjnë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre të drejtpërdrejtë, si dhe të provojnë se në ç'mënyrë ata janë cenuar në të drejtat e tyre kushtetuese. Në këtë kuptim, për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë sesi ai lidhet me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës së tyre kushtetuese për proces të rregullt ligjor, ndërkohë që, në thelb, ai synon mbrojtjen e të drejtave të personave të tjerë në procesin gjyqësor. Për më tepër, këta të fundit janë thirrur në këtë proces kushtetues në cilësinë e subjekteve të interesuara dhe nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor të përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe pasi kanë shteruar, të paktën në formë, mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 12.6.2024 dhe referuar informacionit të përcjellë me shkresë nga kjo e fundit, vendimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 20.9.2024, kur është publikuar në faqen zyrtare të saj, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 16.1.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar të drejtën për proces të rregull, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, asaj për t'u mbrojtur e dëgjuar, si dhe në aspekt të sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar, për rrjedhojë atyre u cenohet edhe e drejta e pronës private, e parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Bazuar në natyrën dhe thelbin e tyre, Gjykata çmon që këto pretendime t'i shqyrtojë në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të "gjësë së gjykuar".

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e dëgjuar

18. Kërkuesit kanë pretenduar se ata nuk janë njoftuar për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë edhe pse në rekurs gjendej adresa elektronike e avokatit. Çështja është shqyrtuar me përparësi pas kërkesës së bërë nga pala tjetër dhe kërkuesve nuk u është dhënë mundësia të njihen me kërkesat e tyre. Për nga natyra e çështjes ajo nuk duhej shqyrtuar në dhomën e këshillimit, por duhej t'u jepej mundësia palëve të paraqisnin pretendimet e tyre në mënyrë të barabartë përpara gjykatës, duke përdorur të njëjtat armë dhe duke zhvilluar debatin gjyqësor dhe kontradiktoritetin, pa vendosur në disavantazh kërkuesit.

19. Subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, kanë prapësuar se kërkuesit nuk kanë provuar se nga mosnjoftimi për fazën e shqyrtimit të pranueshmërisë së rekursit, atyre u ka ardhur ndonjë pasojë konkrete dhe e pakthyeshme në ushtrimin efektiv të së drejtës për mbrojtje dhe në barazinë e palëve. Për më tepër, sipas tyre, ky pretendim nuk mund të ngrihet në një fazë formale, jokontradiktore të procesit, në kushtet kur vetë ligji nuk parashikon detyrimin për një

njoftim të tillë. Pavarësisht se kanë paraqitur rekurs, kërkuessit kanë qëndruar pasivë gjatë gjithë periudhës 2018-2024, duke mos depozituar asnjë qëndrim, sqarim ose kërkesë për informacion dhe nuk rezulton të kenë pasur pengesë objektive që t'u ketë pamundësuar atyre ndjekjen e procedurës.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, ai të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes (*shih vendimet nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 12, datë 6.6.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se, para së gjithash, e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, e drejta për t'u dëgjuar nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, për sa kohë që individ i ka pasur mundësinë që të paraqesë pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 23, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas saj, parimi i kontradiktoritetit në gjykim dhe ai i barazisë së armëve kërkojnë krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose të përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe për deklaratimet e tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 21, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 6.7.2015; nr. 13, datë 21.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese dhe rrethanave të rastit konkret, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuessve u është cenuar ose jo e drejta e aksesit e lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e dëgjuar gjatë procesit në Gjykatën e Lartë. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e kërkuessve të vitit 2017. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, kategoria “Çështje civile”, nënrubrika “Për shqyrtim në dhomën e këshillimit”, rezulton se në datën 5.6.2024 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 12.6.2024, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues, në të cilën pasqyrohet çështja e kërkuessve. Nga të dhënat e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se avokati i kërkuessve, që i ka përfaqësuar ata në Gjykatën e Lartë, është informuar edhe në rrugë elektronike nga administrata e asaj gjykate në datën 25.10.2023 për planifikimin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në datën 22.11.2023. Rezulton, gjithashtu, se çështja nuk është shqyrtuar në datën e planifikuar, por është shtyrë disa herë për shkak të ndryshimit të anëtarëve të trupit gjykues dhe është shqyrtuar përfundimisht në datën 12.6.2024 në dhomën e këshillimit. Për çdo shtyrje, njoftimi është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate.

22. Referuar dispozitave që rregullojnë shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 482 i KPC-së) ose në prani të palëve (neni 482/a i KPC-së), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në mjediset e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur

palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit (neni 482/a, pika 2, i KPC-së).

23. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkuesit, të përfaqësuar nga avokati i zgjedhur prej tyre, të cilët kanë pasur mundësinë të parashtrojnë të gjitha pretendimet e tyre në të, si dhe faktin se subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, nuk kanë paraqitur kundërrekurs, por vetëm kërkesa për përshpejtimin e gjykimit. Në këto kushte dhe në mungesë të ndonjë argumenti të qenësishëm kushtetues nga ana e kërkuesve në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se nuk provohet që ata të jenë vendosur në pozita të pafavorshme në krahasim me palën tjetër në proces në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar në aspektin substancial.

24. Për sa i përket argumentit se kjo e drejtë është cenuar për shkak të formës së gjykimit të çështjes së kërkuesve nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se faza e shqyrtimit paraprak është procedurë e cila zhvillohet gjithnjë në dhomën e këshillimit dhe kompetencat e kolegjit të Gjykatës së Lartë ushtrohen *de plano*, pasi lidhen me seleksionimin e rekurseve që plotësojnë kriteret ligjore, ndërsa për rekursin që nuk plotësojnë kriteret e nenit 472 të KPC-së vendoset mospranimi i tyre bazuar në nenin 480 të po këtij kodi. Shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 30, datë 22.4.2025; nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 31, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale të nenit 480 të KPC-së, sipas të cilave mospranimi i rekursit vendoset në dhomën e këshillimit, pra pa praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga kjo dispozitë. Po kështu, Gjykata evidenton se kërkuesit, edhe pse kanë barrën e provës në këtë drejtim, nuk kanë arritur të provojnë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit.

25. Për sa i takon pretendimit të kërkuesve lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, Gjykata vlerëson se, pavarësisht se ligji procedural nuk përcakton në mënyrë të shprehur detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e palëve për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit në kuadër të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së tij, ajo gjykatë i ka njoftuar palët sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit që ligji procedural ka përcaktuar për të, duke u bërë të ditur atyre datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ajo i ka njoftuar kërkuesit edhe individualisht, nëpërmjet adresës elektronike të avokatit të tyre, duke garantuar për palët dhe, në veçanti për kërkuesit, të drejtën për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe njoftimin e rregullt si element të këtij procesi.

26. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e dëgjuar është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të "gjësë së gjykuar"

27. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat në vendimet objekt ankimi, duke arsyetuar se pretendimi për vërtetësinë e vendimit të Gjykatës së Paqit nuk është marrë në shqyrtim nga gjykatat në vendimet gjyqësore të mëparshme dhe se pretendimi i kërkuesve për cenimin e sigurisë juridike nuk qëndron, nuk mbajnë në konsideratë parashikimin e nenit 451/a të KPC-së për vendimin e formës së prerë. Në rastin konkret, vendimet e mëparshme janë të formës së prerë, kanë të njëjtat palë, të njëjtin objekt dhe bazë ligjore. Interpretimi i tyre, sipas kërkuesve, është tërësisht i ndryshëm edhe nga vendimi nr. 1862/2011 i gjykatës së apelit, e cila e ka vlerësuar këtë çështje si gjë të gjykuar. Nga ana tjetër, gjatë procesit kryesor është administruar si provë edhe origjinali i vendimit të Gjykatës së Paqit, ndaj falsiteti i vendimit të noterizuar nuk mund të pretendohet. Edhe akti i ekspertimit ka konfirmuar se dokumenti në tërësi ruan vjetërsinë e tij, në këto kushte gjykata

e apelit nuk ka kryer një riekspertim, por vite më pas vendimi është deklaruar i falsifikuar në bazë të një hetimi të vitit 1998. Në çdo rast, sipas kërkesve, vërtetësia e vendimit në fjalë nuk ka rëndësi të posaçme për vërtetimin e pronësisë, pasi është një provë si gjithë të tjerat.

28. Subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 38/2016 që ka kthyer çështjen për rigjykim, ka konstatuar se vlefshmëria dhe ndikimi juridik i vendimit të Gjykatës së Paqit përbëjnë çështje të hapur, pasi kërkon vlerësim të plotë dhe hetim material nga gjykatat e faktit, duke e përjashtuar kështu ekzistencën e “gjësë së gjykuar”. Vendimet e mosfillimit të procedimit penal nuk përbëjnë pengesë procedurale për vijimin e shqyrtimit civil. Për më tepër, sipas këtyre subjekteve të interesuara, kërkesit kanë qëndrim kontradiktor lidhur me rëndësinë e kësaj prove, në kushtet që vetë ata e kanë trajtuar vendimin në fjalë si provë qendrore për mbështetjen e pretendimeve të tyre pronësore.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 19, datë 1.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Po kështu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, i cili nënkupton, mes të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i këtij parimi, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në lidhje me parimin *res judicata*, Gjykata ka theksuar se në aspektin formal e procedural gjë e gjykuar nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, si një element themelor edhe i gjykimit të drejtë, do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vet sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata ka çmuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së

drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Për sa më lart, pas shqyrtimit të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

33. Konkretisht, *sipas njërit qëndrim*, pretendimi i kërkuar për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar është i pabazuar.

34. Ashtu siç kanë parashtruar edhe kërkuar, neni 451/a i KPC-së parashikon se vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Referuar edhe vendimeve gjyqësore të mëparshme, vërehet se proceset gjyqësore kanë pasur objekt dhe shkak të ndryshëm nga njeri-tjetri. Pavarësisht faktit se edhe gjatë procesit kryesor subjektet e interesuara, pala paditëse, kanë ngritur pretendime rreth pavërtetësisë së vendimit të Gjykatës së Paqit, ato pretendime nuk janë marrë në shqyrtim nga gjykatat me arsytimin se paditësit nuk kishin zgjedhur mjetin e duhur ligjor, duke i orientuar ata. Ndërsa në procesin gjyqësor me objekt deklarinimin të falsifikuar të vendimit të Gjykatës së Paqit, gjykatat kanë shqyrtuar dhe janë shprehur për pretendimin për pavërtetësinë e tij, duke e gjetur atë të bazuar dhe duke arritur në përfundimin se ai vendim është i falsifikuar.

35. Konkretisht, gjykata e apelit, në vendimin objekt ankimi, ka arsyetuar lidhur me realizimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, për hetimin e origjinës së pronës objekt mosmarrëveshjeje dhe për hetimin e përputhshmërisë midis vendimeve të Gjykatës së Paqit, duke arritur në përfundimin se vendimi i kundërshtuar është i falsifikuar. Ajo gjykatë ka arsyetuar edhe për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, të cilin e ka gjetur të pabazuar, duke referuar për këtë në arsytimin shterues të vendimit nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim. Edhe Gjykata e Lartë, në vendimin objekt ankimi, e ka shqyrtuar pretendimin e kërkuar për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe “gjësë së gjykuar” dhe ka vlerësuar se ai është marrë në shqyrtim gjatë gjykimeve të mëparshme dhe se kërkuar kanë marrë përgjigje për të. Me anë të vendimit nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë, ku janë bazuar ato gjykata, është konkluduar rreth faktit se asnjë nga vendimet gjyqësore të mëparshme nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim, duke arritur në përfundimin se në rastin konkret nuk mund të ketë cenim të sigurisë juridike për të drejta që pretendohet se janë fituar në mënyrë të kundërligjshme.

36. Për sa më sipër, sipas këtij qëndrimi, gjykatat në vendimet e kundërshtuara kanë bërë një analizë të plotë të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të zakonshme përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse, duke analizuar në lidhje me ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar, duke arritur më pas në përfundimin se pretendimi për cenimin e sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar nuk qëndron.

37. Për sa i takon pretendimit të kërkuar se në vendimet e kundërshtuara është bërë një interpretim tërësisht të ndryshëm nga ai i gjykatës së apelit me vendimin nr. 1862/2011, vihet në dukje se ky i fundit nuk është i formës së prerë, për shkak se është prishur me vendimin nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë dhe procesi është përmbyllur me vendimet objekt ankimi kushtetues. Në këto kushte, nuk mund të konkludojmë se arsytimi i vendimit të referuar të gjykatës së apelit ishte i detyrueshëm për gjykatat, pasi nuk jemi në situatën e ndonjë të drejte të fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë, si element i këtij parimi. Nga ana tjetër, vlerësohet se argumentet e kërkuar, në thelb, kanë të bëjnë me vendimin nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë, me anë të të cilit çështja

është kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit, vendim i cili nuk rezulton të jetë kundërshtuar më parë nga kërkuesit as në këtë Gjykatë dhe, në konsideratë të juridiksionit të kufizuar të saj në atë kohë, as në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

38. Për rrjedhojë, kërkesa duhej rrëzuar, pasi pretendimi kryesor i kërkuesve që lidhet me cenimin e parimit të sigurisë juridike, është i pabazuar, duke qenë se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë dhënë në shkelje të këtij parimi.^{1 2}

39. Ndërsa, sipas *qëndrimit tjetër*, kërkesa duhej pranuar, pasi pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar është i bazuar. Duhet ritheksuar se, sipas këtij parimi, kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjëja e gjykuar përfshin edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Këto standarde në çështjen konkrete rezultojnë të mos jenë respektuar. Kështu, pretendimi për falsitetin e aktit noterial është shqyrtuar dhe është rrëzuar me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 11.6.1997. Në atë gjykim rezulton se është administruar, në cilësinë e provës, origjinali i vendimit të datës 2.2.1939, të Gjykatës së Paqit, që sipas aktit të ekspertimit, në tërësinë e tij, ruante vjetërsinë e përpilimit të letrës, të makinës së shkrimit të përdorur, të gjuhës së shprehur, si dhe pullat e vulat me mbishkrimet përkatëse. Ky vlerësim është bërë përfundimtar, pasi Gjykata e Kasacionit, me vendimin e datës 7.11.1997, ka vendosur mospranimin e rekursit. Për rrjedhojë, çështja e vërtetësisë së vendimit të Gjykatës së Paqit mori cilësinë e gjësë së gjykuar, ndaj në respektim të parimit të sigurisë juridike, asnjë gjykatë nuk mund ta gjykonte sërish atë, pa ndjekur procedurat ligjore për riparimin e gabimeve të rënda në administrimin e drejtësisë, siç është procedura e rishikimit.

41. Në vijim, në vendimin e datës 21.9.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vënë në dukje se pretendimet për falsitetin e vërtetësisë së vendimit të Gjykatës së Paqit nuk mund të pranohen, pasi janë gjetur të pabazuara me vendime gjyqësore përfundimtare. Megjithatë, Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 5.2.2016, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, e ka rihapur sërish çështjen e falsitetit, duke ia nënshtruar përsëri debatit dhe vlerësimit gjyqësor, pa u ndalur në vlerën e gjësë së gjykuar që ajo çështje kishte marrë. Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, duke lënë si detyrë se duhej verifikuar sërish pretendimi për falsifikimin e atij vendimi. Në zbatim të këtij vendimi, gjykata e apelit dhe, më pas, Gjykata e Lartë kanë dhënë vendimet e kundërshtuara, të cilat po ashtu janë në shkelje të parimit të sigurisë juridike.

42. Gjithashtu, duhet vënë në dukje se kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, duke zbatuar në këtë mënyrë parimin e subsidiaritetit dhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike. Për këtë të fundit, Gjykata ka pohuar se duhet përmbushur edhe kur procedurat gjyqësore çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 75, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, vendimi i Gjykatës së Lartë i vitit 2016, që është shkaku kryesor i cenimit të parimit të sigurisë juridike, i takon periudhës në të cilën juridiksioni i

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.

² Gjyqtari Asim Vokshi votoi për rrëzimin e kërkesës, për shkak të mungesës së legjitimitetit *ratione temporis*, sipas mendimit paralel të këtij vendimi.

Gjykatës ishte i kufizuar vetëm për të drejtën e procesit të rregullt ligjor, si rezultat i së cilës kthimi i çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë nuk i nënshtrohej kontrollit kushtetues. Rrjedhimisht, qasja e mëparshme e Gjykatës nuk mund të rëndojë mbi të drejtat kushtetuese themelore të kërkuësve, në kuptimin që Gjykata të vendoste mospranimin e ankimit kushtetues individual me argumentin se ata, në vitin 2016, nuk kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë. Ky argument u ngarkon atyre një barrë të tepruar, që e shndërron të drejtën themelore kushtetuese në teorike dhe iluzive.

43. Për sa më lart, kërkesa duhej pranuar dhe Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që janë dhënë në shkelje të parimit të sigurisë juridike.³

44. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata çmon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuësve konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 133, pika 2, shkronja “i” dhe 134, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.2.2026.

Shpallur më 12.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sonila Bejtja, Asim Vokshi

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuësve Kadri Pazari dhe Engjëll Kazazi, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1442, datë 5.6.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 00-2024-2489, datë 12.6.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, ndonëse jam dakord me dispozitivin e vendimit për rrëzimin e kërkesës, për sa i përket motivit kryesor dhe thelbësor të saj, në lidhje me cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, vlerësoj se kërkesa është e papranueshme *ratione temporis*.

2. Vlerësoj se kundërshtimi në kohë nga kërkuësit i vendimit të datës 12.6.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk e vendos atë palë brenda afatit për kundërshtimin e qëndrimit përfundimtar të gjykatave në lidhje me zbatimin prej tyre të parimit të gjësë së gjykuar. Pa përsëritur në këtë mendim paralel faktet e çështjes, të cilat janë parashtruar në vendimin e Gjykatës, konstatoj se çështja e qenies gjë e gjykuar e pretendimeve të palëve për falsitetin e disa provave themelore që kanë çuar në marrjen e vendimit nr. 1319, datë 12.3.1997, të Gjykatës së Rrethit

³ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari dhe Marjana Semini.

Gjyqësor Tiranë (lënë në fuqi me vendimin nr. 1515, datë 11.6.1997, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendosur mospranimi i rekursit nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. 1303, datë 7.11.1997), është vendosur përfundimisht me vendimin nr. 38, datë 5.2.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka rrëzuar në themel pretendimin për cenimin e gjësë së gjykuar dhe ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe kthyer çështjen për rigjykim, duke lënë detyra konkrete për hetimin e plotë gjyqësor të çështjes.

3. Vendimi nr. 38/2016 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse u ka mbyllur rrugën përfundimisht pretendimeve për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar (duke thënë fjalën e fundit për këtë aspekt), nuk është kundërshtuar nëpërmjet ankimit kushtetues individual, nga ana e kërkuarve dhe të paditurve të tjerë, në Gjykatë. Rrjedhimisht, kërkuarët e kanë humbur mundësinë për vënien në diskutim të këtij elementi të rëndësishëm, për sa kohë që nuk e kanë kundërshtuar në kohë atë në Gjykatë, pasi nëpërmjet atij vendimi Gjykata e Lartë, konform kompetencës së saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe dhënien e udhëzimeve të detyrueshme për gjykatat më të ulëta në rigjykim, ka dhënë orientime që në vetvete përbëjnë gjë të gjykuar për sa i përket moscenimit të gjësë së gjykuar nga padia e paditësve në gjykimin për deklarimin të falsifikuar të vendimit nr. 518 (508) të Gjykatës së Paqit. Duke qenë ky pretendimi i vetëm me vlerë kushtetuese, ku i mbështesin kërkimet kërkuarët, por i paraqitur jashtë afatit (pasi vendimi i Gjykatës së Lartë që e ka zgjidhur këtë çështje është i vitit 2016), kërkesa e tyre duhej deklaruar e papranueshme për shqyrtim *ratione temporis* ose të rrëzohej me këtë arsyetim.

Anëtar: Asim Vokshi